



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË
BASHKISË SHKODËR”**

Konsultim publik : Rajoni nr.5.

Data : 23.09.2025

Ora : 13.00

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : Numri i pjesëmarrësve 34, nga të cilat 10 gra.

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Për draft projekt planin buxhetor afatmesem 2026-2028 të Bashkisë Shkodër.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Zv.Kryetari i Bashkisë Z.Alban Preka, i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fillimisht fjalën e merr **Znj.Donika Ndoja**, administratore e Rajonit nr.5 i cili bën një përmbledhje të punëve dhe investimeve të kryera për lagjen nr.5 të qytetit.

Më pas fjalën e merr Zv.Kryetari i Bashkisë, **Z. Alban Preka**, i cili falënderon pjesëmarrësit për angazhimin. dhe fton të pranishmit që të trajtojnë nevojat dhe problematikat e zonës së tyre, në mënyrë që për vitin tjetër të kemi mundësinë të ndërhyjmë dhe të planifikojmë buxhetin sipas prioriteteve dhe emergjencave në këto rajon. Ai siguron qytetarët që çdo gjë do mbahet shënim dhe do reflektohet në proces verbalin e këtij takimi duke u trajtuar më pas nga strukturat e Bashkisë Shkodër.

Z. Klaudio Pemaj, banor rruga “Tepe” lagjja “Daniel Matlija”:

- Në zonën e Qafëhardhisë, rruga është e gjitha me ndërtime mbi trotuar, prandaj kërkojmë ndërhyrjen tuaj.
- Kemi një rrugicë rreth 70 metra, që nuk është vënë dorë asnjë herë, e cila ka nevojë për rikualifikim të ujërave të bardha e të zeza dhe asfaltim, sepse është rrugë e cila përmbytet dhe aksesit aty bëhet i pamundur sapo fillojnë rreshjet.

Z.Preka shprehet se realisht përgëzon të punonjësit që janë të angazhuar në proces e lirimit të hapësirave publike. Ai shton se është filluar me rrugët kryesore e do të vijohet me këtë ritëm në çdo sipërfaqe dhe zonë të qytetit. Kemi tashmë edhe portalin “Hapësira ime”, ku mund të publikohet çdo problematike. Por duhet të kemi parasysh që kudo ku ndërhyhet për lirin e hapësirave duhet të kemi më pas investime në sistemim, gjë kjo që ka kosto financiare, prandaj dhe na duhet kohë. Megjithatë do kemi edhe fazën e dytë të kapotave dhe jemi në proces edhe për investime të tjera.

Administratorja **Znj.Ndoja** sqaron se për rrugën Qafëhardhi, jemi në proces për ndërhyrje sapo të përfundojë puna në rrugët dhe bulevardet kryesore.

Z. Gjergj Sokoli, banor i lagjes “Mar Lula” shprehet se falenderon Bashkinë për rrugën Roza Lejn dhe mezi e presin të fillojë puna në këtë rrugë. Ai shton:

- Në lidhje me kazanat në këtë lagje, kemi një problem tek rruga “Mehmet Shpendi” dhe rruga “Milan Shuflaj”, duhet të shihet mundësia për vendosje të kazanave të mbeturinave sepse nuk kemi asnjë pikë grumbullimi.

Sqaron përsëri **Znj.Ndoja** duke thënë se problemi për këtë propozim ka të bëjë me mjetin që bën evadimin, i cili nuk mund të futet në këto rrugë të ngushta. Kemi patur edhe një mënyrë ndërhyrjeje me ndihmën e komunitetit aty, duke bërë ato vetë kanalizimet e ujërave të bardha e të zeza dhe kemi edhe 5 rrugë të cilat i kanë kanalizimet, por duhet bërë vetëm asfaltimi.

Drejtoresha e shkollës “Edit Durham” falenderon për ndërhyrjet që keni realizuar dhe shton se:

- Ngrohja në shkollën tonë vijon akoma me bombula gazi

Sqaron **Z.Kullaj**, nga administrata duke thënë se brenda këtij viti do të vendoset në efijence kaldaja.

Znj. Albana Neziri, banore lagjja “Ndoc Mazi, rruga “Edit Durham”

- Oborri dhe hapësira publike pranë pallateve tona është totalisht jashtë funksioni dhe kemi nevojë që të ketë një projekt rikualifikimi për këtë. Ndodhet në mes të Shkodrës prandaj rikualifikimi i tij duhet të jetë prioritet.

Z. Ndue Vata, banor rruga “Malet Tona”:

- Koshat e mbeturinave i kemi shumë larg shtëpisë dhe është e pamundur ti transportojmë kaq larg.

Z. Altin Salihi, nga administrata shprehet se nëse ju si lagje na orientoni dhe bini dakort për një vend të përshtatshëm, ne j’ua vendosim menjëherë.

Banor, lagja “3 Heronjt, rruga “Frang Bardhi:

- Në rrugën tonë nuk është vënë dorë asnjëherë.
- Nuk ka as ka ndriçim, as kanalizime dhe asgjë. Është shumë problematike për ne kjo mungesë investimesh.
- Nga ish fabrika e miellit deri tek stacioni i trenit, janë disa rrugë, ku është ndërhyrë dhe vetëm rruga jonë dhe një tjetër janë të paprekura.

Zv. Kryetari Z. Preka shprehet se nuk mund të fajësohemi për 35 vitet e shkuara dhe na vjen mirë për besimin që keni tek Bashkia për të bërë një ndryshim. Ju falenderoj që shprehet problematikën tuaj dhe patjetër do të vlerësohet mundësia dhe do jetë me prioritet.

Po ashtu edhe **Znj. Ndoja** shton se banorët e kësaj zone e kanë paraqitur me vite këtë problematikë, Janë disa rrugë të bëra prej vitesh, por në rrugët “Frang Bardhi” dhe “Dora D’istria” nuk është ndërhyrë asnjëherë. I kemi inspektuar dhe problematika në këto rrugë nuk është vetëm investimi por edhe zënia e hapësirës së rrugës. Por kërkojmë edhe mirëkuptimin tuaj sepse janë punë që kërkojnë kohën e vet.

Z. Gjon Ugilaj, banor rajoni nr.3 përgëzon për çdo punë të kryer duke bërë edhe një krahasim me Bashkinë e kaluar. Nuk po flas për projektet strategjike por më shumë për ndërhyrjet që po bëhen. Ai shpreh edhe disa shqetësime:

- Pranë pallatit prapa biznesit tonë çdo pusëtë dhe kanalizim është i bllokuar, prandaj duhet të bëhet lirimi i këtyre hapësirave sepse as zjarrëfiksja nuk mund të kalojë.
- Sugjeroj që ndriçimi duhet të bëhet edhe me panele diellore.
- Sa i përket parkingjeve, duhet të planifikoni edhe parkingje nëntoksore.
- Të mendohet për mjete me bateri për lëvizjen e stafit dhe sidomos Policisë Bashkiake.
- Sa i përket shkollave, mendoj që edhe vetë drejtorët e shkollave duhet të angazhojnë komunitetin për të bërë investime në shkollat e tyre. Duhet të ketë bashkëpunim mes palëve për të patur zgjidhje më të mira.
- Në lidhje me certifikimin e pronave tona , duhet të ketë nxitje tek Hipoteka për të nxitur këtë këtë process.
- Ndotja akustike, mendoj që besimi është në zemër dhe duhet që nga institucionet fetare të mendohet kjo gjë sepse ndikon tek turistët.

- Tjetër problematikë janë edhe objektet e pabanuara, që përveç imazhit të shëmtuar, përbëjnë edhe rrezikshmëri për kalimtarët prandaj duhet gjetur një zgjithje për to.
- Tjetër sugjerim do ishte, që njerëzit që janë përfitues të ndihmës sociale, të shihet mundësia e gjetjes së një pune për to. Janë shumë punë që këto njerëz mund ti bëjnë shumë mirë duke përfitura pavarësi ekonomike.

Z.Preka sqaron se po bëjmë një punë shumë të mirë duke evidentuar pjesën më të madhe të rrugëve ku pengohet hyrja e zjarrëfikëseve, për të vijuar pastaj me ekzekutim të këtyre ndërhyrjeve. Kemi akoma ndërtesa dhe vende ku përdoret eterni, i cili është shumë i rrezikshëm për banorët. Edhe për rrugët e biçikletave jemi në process, dhe është përherë e në rritje ndërtimi i këtyre korsive duke sistemuar kështu trafikun por edhe duke ndikuar në shëndetin e përdoruesve. Në lagjen “Ndoc Mazi” dhe rrugën “Edit Durham” po ndërtohet pallati i madh me hark me riveshje të fasadës. Është një proces në vazhdim me FSHZH-në për të përfshirë të gjithë qytetin për veshjen me kapotë.

Z. Lec Corri, banor lagjja “3 Heronjt”:

- Rruga “Dalmacia” është shtruar, por ka pësuar shembje sepse punimet kanë qenë të dobëta dhe akoma nuk janë vendosur as shtyllat e ndriçimit.

Z. Lush Marku, banor rruga Mark Ndou:

- Rruga pranë stacionit të trenit ka nevojë emergjente për ndërhyrje, nuk është vënë dorë asnjëherë edhe pse janë dorëzuar pafund kerkesa në Bashki prej shumë vitesh tashmë.
- Rruga “Mark Ndou” sa herë që bie shi bëhet e pakalueshme.

Znj. Ndoja shprehet se është filluar prej vitesh një investim aty por nuk është përfunduar, dhe do shihet me prioritet nga Bashkia.

Përfaqësues të shkollës “Martin Camaj” shprehen se problematika e tyre vazhdon të jetë në lidhje me rrethimin dhe mjedisin përpara shkollës.

Z.Preka thotë se është fituar nga kompania përkatëse projekti për të ndërhyrë në bllokun e pallateve “Martin Camaj”, i cili do të ndikojë në rikualifikim edhe të oborrit. Edhe me ZVA-në jemi në kontakt për të parë mundësinë e transferimit të tyre.

Znj. Rajmonda Ugilaj, përfaqësuesë biznesi, merr fjalën dhe propozon që avullitë dhe muret rrethuese të shtëpive janë imazh i shëmtuar, dhe duhet menduar për një sistemim uniform për gjithë qytetin. Për më tepër këto mure bëhen pengesë edhe në kalimin e mjeteve si zjarrëfikëset apo ambulancat. Mendoj se ju si Bashki t’i orientoni banorët për të mbajtur mure të ulta. Gjithashtu edhe tarabat e qytetit, mund të bëhen projekte për të investuar dhe vendosur taraba me të lehta dhe më elegante.

Znj. Alma Mehmetaj, anëtare e Këshillit Bashkiak dhe banore e lagjes nr. 5 shprehet se gjatë javës kam qenë në kontakt të vazhdueshëm me banorët. Ajo ngre disa problematika të zonës:

- Kemi një rrugicë pranë “Urës së Thive”, ka nevojë për asfaltim sepse nuk është investuar asnjë herë, duhet parë situatë në terren.
- Nga shkolla “Edit Durham” drejt pallateve tek ish- Fusha e druve ka nevojë që të ketë bume për kufizim të shpejtësisë sepse edhe prania e shkollës dhe fëmijët e bëjnë të nevojshme vendosjen e bumeve.
- U përmendën këndet e lojrave dhe doja të kujtoja se edhe pranë pallateve tek fusha e druve ka qenë një, por shumë i rrezikshëm dhe kërkojmë që të ndërhyhet dhe të bëhen sërish me parametrat e duhura.
- Për zonën tonë jam në dijeni që ka edhe një projekt shumë të madh nga Agjencia e Ujësjetllës kanalizimeve, që do të bëjë ndërhyrje totale.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka **Z.Alban Preka**, Zv.Kryetar i Bashkisë mbyll takimin duke vlerësuar edhe njëherë pjesëmarrjen e të pranishmëve dhe propozimet.

Zbardhi proces verbalin :

Bekim Mema

Irma Sulishti



SEKRETARE

Sabina Danaj






REPUBLIKA E SHQIPËRISË




BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENÇË
(Lagjia nr.5)

KONSULTIM PUBLIK: “Për Miratimin e Projektbuxhetit 2026 dhe Programit Buxhetor afatmesëm 2026-2028, të Bashkisë Shkodër”

Data: 23.09.2025

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1.	Albano Dervin	Dobë Hazi	0674997727		
2.	Ema Shkoder	Shkoderi			
3.	Ejona Kocaku	Mark fuba	0699102603		
4.	Ardenis Jorshini	B. Shkoder	0672000957		
5.	Dubona Jeshari	Perash 'M. Camaj'	0672031657		
6.	Arben Mustafaj	Sk. 'M. Camaj'	0674060585		
7.	ALTIN PALIHI	NSHP	0681042990	plkinfo@shkoder.com	
8.	Alban Shabij	NSHP	0672626966	albanshabij@gmail.com	

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJJA/FSHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9.	Ervin Bishari	Koordinator	0694063981	—	
10.	Harvio Ullasaj	B. Shkodër	0684063801	Harvio.malocaj@boshkeshi.kosov.gov.al	
11.	Dometio Kallaj	B. Shkodër	0673510001	Dometio.kallaj@boshkeshi.kosov.gov.al	
12.	ERGJ PERAZI	N. MATI	0698739351	—	
13.	Bede Curri	3 Heronjtë	0682983569	—	
14.	Enan Abi	3 Heronjtë	0682983569	—	
15.	Andrit Behari	A.T.F.V	0692484025	Andritbehari@boshkeshi.kosov.gov.al	
16.	Pal Pepaj	Lagje MATI	0682333441	palpepaj@yahoo.com	
17.	Harqelidh Mersakovic	Lagje MATI	0695123813	—	
18.	Edmond Mervinaj	Lagje MATI	0682322219	—	
19.	Pieter Greku	3 Heronjtë	0682245913	—	
20.	Pieter Xhanaj	3 Heronjtë Rr. F. Basha	0692153980	—	
21.	Abdullahi	3 KEROJ RR. FRANK BARRILI	0672034777	—	
22.	Gjergj Tsoke	3 Heronjtë	0682313970	—	
23.	Luigj Lami	3 Heronjtë	—	NR 06725638	
24.	Armen Shkollari	3 Heronjtë	—	Evangelos Bar	
25.	Glibon Dibra	Solo Heliç	0692732747	tanisaboni@boshkeshi.kosov.gov.al	
26.	Mimosa Durraku	Tre Heronjtë	0672674898	mimosa.durraku@boshkeshi.kosov.gov.al	
27.	Nolue Velp	2. Heronjtë	0692893734	—	
28.	Arta Dardani	Polina Boshkeshi	0699488831	artadardani@icloud.com	

[illegible]